



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:188415
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05601455

C.nr.1794/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit B.Sh. nga fshati T., Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson Filloreta Hoxha-Zymberaj, avokate nga Peja, me autorizim, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, me adresë lagjja Kalabria nr.5, blloku B1, Prishtinë, vlera e kontestit 800 euro, me bazë juridike kompensim dëmi, jashtë seance me datën 22.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit B.Sh. nga fshati T., Komuna e Pejës, e parashtruar me datë 30.12.2020, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 800 euro.

II. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësi B.Sh. nga fshati T., Komuna e Pejës, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”- Prishtinë, e Re”, në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 800 euro.

Gjykata, me datën 19.01.2024, ka pranuar parashtresën e paditësit të paraqitur përmes të autorizuarës së tij, me anë të së cilës parashtresë, i njëjta ka deklaruar se e tërheqë padinë ndaj të paditurës, me arsyetim se të njëjtit kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore me këtu të paditurën.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e*

padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1794/20, me datë 22.04.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.